



**Republika e Kosovës**

**MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT**

**NDËRMJET**

**Doganës së Kosovës**, përfaqësuar nga Drejtori Gjeneral z. Naim Huruglica

**DHE**

**Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë**, përfaqësuar nga sekretarja e përgjithshme znj. Eljana Naka

Ky memorandum lidhet me qëllim të:

1. Ngritjes dhe përmirësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve në fushën e Pronësisë Intelektuale;
2. Mbrojtjes të së Drejtës së Pronësisë Intelektuale dhe nevojës për implementimin e një metodologjie për mbledhje, vlerësim, dhe sistematizim të të dhënave statistikore në lidhje me kërkesën për veprim dhe shkeljet potenciale të të drejtave të pronësisë intelektuale;
3. Unifikimit të qëndrimeve për zbatimin e drejtë të ligjeve që mbrojnë të Drejtën e Pronësisë Intelektuale;
4. Që Memorandumi i mirëkuptimit të kontribuojë në përmirësimin e komunikimit, shkëmbimit të informacioneve dhe përvojave;

Me datë 27 / 07 / 2011 në zyrën e MTI-----nënshkruan këtë:

## MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

### Neni 1

Bashkëpunimi do të realizohet në këtë mënyrë:

1.1. Dogana e Kosovës (DK) do të parashtrijë një kërkesë me shkrim për Zyrën për pronësi industriale të Kosovës (ZPI) në çdo rast, ku një Bartësi i së Drejtës nuk është në gjendje për të mbështetur apo dëshmuar pretendimin e tij për të mbajtur një të drejtë të pronës intelektuale në Kosovë.

1.2. Kërkesa me shkrim do të marrë një formë të fjalëve, të akorduara nga të dy palët DK dhe ZPI, në mënyrë që të vendosin statusin e çdo aplikimi.

1.3. Kërkesa me shkrim do të shoqërohet me dokumentacion mbështetës të ndryshëm për të mbështetur kërkesën e bartësit të së drejtës (p.sh. përshkrimi figurativ, përshkrimi i logos etj).

1.4. ZPI bie dakord për t'iu përgjigjur DPI-së me shkrim, në letër apo e-mail në afat dhe kohë brenda 30 ditëve.

1.5. DK dhe ZPI bien dakord për shkëmbimin e informatave në lidhje me kontrollin dhe zbatimin e të dhënave në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave të PI-së.

2. Dogana e Kosovës pajtohet që sistemi automatik për pronësinë industriale-IPAS përkohësisht të instalohet në serverët e saj dhe të bëjë mirëmbajtjen e tij. Në të dhënat e ZPI-së, të cilat do të ruhen në këta serverë, nuk do të ketë qasje askush përpos personelit të IT-së dhe zyrtarëve të ZPI-së.

2.1. Dogana e Kosovës për nevoja të shfrytëzimit të IPAS do të sigurojë qasje për numër të mjaftueshëm të përdoruesve të ZPI-së.

2.2. DK-ja dhe ZPI-ja obligohen t'i njoftojnë zyrtarët e tyre për memorandumin në afat prej 7 ditëve nga dita e nënshkrimit.

## **Shkëmbimi i publikimeve**

### **Neni 2**

2.1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi, shkëmbimi i publikimeve do të përfshijë:

- buletinet zyrtare të institucioneve;
- raportet vjetore të institucioneve;
- publikime të tjera nga fusha e pronësisë industriale.

## **Formimi i Komitetit për monitorim**

### **Neni 3**

- 3.1. Për implementimin e dispozitave nga ky memorandum, do të formohet Komiteti për monitorim, i përbërë prej ekspertëve nga të dy institucionet.
- 3.2. Komiteti për monitorim do të takohet me kërkesë të drejtorëve të institucioneve .
- 3.3. Drejtorët e institucioneve do të vendosin për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimeve të Komitetit.

## **Revizioni**

### **Neni 4**

- 4.1. Institucionet rregullisht do t'i shqyrtojnë rezultatet nga implementimi i Memorandumit, aktivitetet e ardhshme të përbashkëta si dhe çështje të tjera me interes të përbashkët.

## **Kushtet Financiare**

### **Neni 5**

- 5.1. Secili institucion do t'i mbulojë harxhimet e veta që dalin nga realizimi i kësaj marrëveshjeje, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me projekt të veçantë.

## Neni 6

**Me qëllim të zbatimit të këtij memorandumi DK dhe MTI do të:**

- 6.1. Organizojnë trajnime të përbashkëta të paktën tre herë në vite në çështjet e identifikuara nga zyrtarët për implementimin e këtij memorandumi;
- 6.2. Mbajnë takime të rregullta mujore;
- 6.3. Krijojnë një databazë të përbashkët me të dhënat për informatat që kanë të bëjnë me bartësit e të drejtave.

## Neni 7

**FILLIMI, KOHEZGJATJA, NDRYSHIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE LIDHUR ME MEMORANDUMIN.**

- 7.1. Ky memorandum nënshkruhet për një kohë të pacaktuar, ndërsa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të fillojë të zbatohet me datë 27 / 07 / 2011.
  - 7.2. Ky memorandum mund të ndryshohet dhe të plotësohet në çdo kohë me pajtimin e palëve nënshkruese.
  - 7.3. Ky memorandum mund të shkëputet në çdo kohë me kërkesën me shkrim të ndonjëres nga palët, e cila e njofton palën tjetër me shkrim të paktën 30 ditë më herët nga dita e kërkesës për shkëputje.
  - 7.4. Kontestet eventuale gjatë zbatimit të këtij memorandumi palët do t'i zgjidhin me marrëveshje.
- Ky memorandum është shkruar në gjuhën shqipe në dy kopje origjinale për secilën palë.

**Dogana e Kosovës**

z. Naim Huruglica, Drejtor i Përgjithshëm

-----

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

znj. Eljana Naka, Sekretare e Përgjithshme

-----

